KOMBET E BASHKUARA

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-T

Data: 29 janar 2008

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: **Gjykatësit Alphons Orie, Kryegjykatës**
Gjykatësit Frank Höpfel
Gjykatësit Ole Bjørn Støle

Sekretari: **Z. Hans Holthuis**

Vendim i datës: **29 janar 2008**

PROKURORJA

kundër
Ramush HARADINAJT
Idriz BALAJT
Lahi BRAHIMAJT

PUBLIK

VENDIM MBI KËRKESËN E IDRIZ BALAJT PËR SEANCË PARAPRAKE NË LIDHJE ME INTERVISTËN E KARLA DEL PONTES

Zyrës së Prokurorit
Z. David Re
Z. Gramsci di Fazio
Z. Gilles Dutertre
Z. Philip Kearney

Avokatëve të Ramush Haradinajt:
Z. Ben Emmerson, QC
Z. Rodney Dixon
Zj.Susan L. Park

Avokatëve të Idriz Balajt:

Z. Gregor Guy-Smith
Zj. Colleen Rohan

Avokatëve të Lahi Brahimajt:
Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop

1. Më 30 tetor 2007, Mbrojtja e Balajt dorëzoi një mocion ku kërkonte që Dhoma të mbajë një seancë paraprake në lidhje me shkeljen e pretenduar prej Prokurores Karla Del Ponte të Standardeve të Prokurorisë për Sjelljen Profesionale të Avokatëve të Prokurorisë ("Standardet").[1] Gjithashtu Mbrojtja e Balajt kërkoi që Dhoma të përcaktojë sanksionet e duhura ndaj Karla Del Pontes pas kësaj seance, nëqoftëse e gjykon të përshtatshme.[2] Mbrojtja e Balajt argumentoi se në një intervistë dhënë revistës "Der Spiegel" më 15 tetor 2007, Zj. Del Ponte komentoi në lidhje memeritat e çështjes gjyqësore *Haradinaj dhe të tjerët* dhe veçanërisht mbi fajësinë e të Akuzuarve.[3] Më tej Mbrojtja e Balajt argumentoi se në të njëjtën intervistë Znj. Del Ponte nuk korigjoi komentin e pasaktë të intervistuesit se në këtë çështhtje janë vrarë një numër dëshmitarësh.[4] Sipas Mbrojtjes së Balajt, Znj. Del Ponte shkeli detyrimet e saj etike sipas Rregullës 2 të Standardeve.[5] Më 6 nëntor 2007, Mbrojtja e Brahimajt iu bashkua Kërkesës.[6]

2. Në pjesën përkatëse të Standardeve shkruhet:

> 1 .Prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) harton këtë Rregullore që përcakton standardet e sjelljes profesionale të cilave do t'u përmbahen avokatët e Zyrës së Prokurorit (ZP) të të dy Tribunalëve.
> (...)
> 2. Gjatë hetimeve dhe gjatë procedurave paragjyqësore, gjyqësore dhe apeluese, avokatët e akuzës do të adoptojnë standardet më të larta të sjelljes profesionale. Prokurori pret që ata, në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e Statutit dhe Rregullores së Procedurës dhe Provave dhe pavarësisë së Prokurorit.:
> a) t'u shërbejnë dhe të mbrojnë interesat publike, ndër të cilat interesat e bashkësisë ndërkombëtare, interesat e viktimave dhe dëshmitarëve, dhe të respektojnë të drejtat themelore të të dyshuarve dhe të akuzuarve;
> (...)
> c) të jenë dhe të duken që janë të qëndrueshëm, të paanshëm dhe të pavarur dhe të shmangin çdo konflikt interesash që mund të dobësojë pavarësinë e prokurorit - veçanërisht avokatët e akuzës nuk do të lejojnë që të ndikohen prej faktorëve kombëtarë, etnikë, fetarë ose politikë.
> (...)
> h) të ndihmojnë Tribunalin për arritjen e të vërtesës dhe drejtësisë për bashkësinë ndërkombëtare, viktimat dhe të akuzuarit;
> (...)
> k) jashtë sallave gjyqësore të shmangin komentet publike ose biseda me median në lidhje me meritat e çështjeve të caktuara ose në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarvve të caktuar në një kohë që ende nuk është marrë vendimi prej një Dhome të Tribunalit në lidhje me çështjen përkatëse;
> (...)
> 4. Mosrespektimi i standardeve të lartpërmendura prej avokatëve të akuzës do të shqyrtohet prej Prokurorit që ushtron kompetencën e vetë dhe në përputhje me rregullat për personelin e Kombeve të Bashkuara, përveç sanksioneve që në raste të jashtëzakonshme mund të ndërmerren ndaj avokatëve të Prokurorisë bazuar në Rregullat 46 ose 77 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të të dy Tribunalëve (ose dispozitave të tjera të Statutit dhe Rregullores)

---

[1] Idriz Balaj's Citation of Prosecutorial Violation of Ethical Code of Conduct and Request for Evidentiary Hearing Regarding Interview of Carla Del Ponte, 30 October 2007 ("Request"), para 18/Citimi prej Idriz Balajt i Shkelejes Prokuroriale të Kodit Etik të Sjelljes dhe Kërkesë për Seancë Paraprake Në lidhje me Intervistën e Karla Del Pontes, 30 tetor 2007 ("Kërkesë"), paragrafi 18/ Dhoma thekson se megjithëse Zj. Del Ponte ishte Prokurore në kohën që u dorëzua Kërkesa, ajo nuk është më në këtë detyrë në kohën e këtij vendimi

[2] Po aty, paragrafi 18.

[3] Po aty, paragragët 1-2, 10-12. Mbrojtja e Balajt citoi edhe nga një artikull në faqen e "B92" në Internet, por ai artikull ishte bazuar në një lajm të Radios Free Europe që nga ana e saj kishte cituar nga intervista e dhënë në "Der Spiegel"

[4] Po aty, pragrafët 2, 13-14, Shtojca A e Kërkesës.

[5] Po aty, paragrafët 12, 17.

[6] Lahi Brahimaj's Joinder with Idriz Balaj's Citation of Prosecutorial Violation of Ethical Code of Conduct and Request for Evidentiary Hearing Regarding Interview of Ms. Carla Del Ponte, 6 November 2007./Bashkim i Lahi Brahimajt me Citimin prej Idriz Balajt të Shkeljes Prokuroriale të Kodit Etik të Sjelljes dhe Kërkesën për Seamcë Paraprake Në lidhje me Intervistën e Zj. Karla Del Ponte, 6 nëntor 2007.

3. Në Kërkesë shkelja e dispozitave të Rregullës 2 të Standardeve merret si pikënisje. Mirëpo anashkalohet Rregulla 4 sipas të cilës Prokurori/ja do të shqyrtojë mosrespektimin e Standardeve. Kjo përputhet me natyrën e Standardeve hartuar prej Prokurorit për të shërbyer si udhëzues për avokatët e akuzës si gjatë hetimeve po ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor.

4. Mbrojtja e Balajt nuk i është referuar Rregullës 46 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit ("Rregullorja"). Rregulla e autorizon Dhomën të vendosë sanksione ndaj avokatëve në rast shkeljeje dhe aty lexohet:

> (A) N.q.s. një Gjykatës ose një Dhomë gjykon se sjellja e një avokati është fyese ose keqpërdorëse ose ndryshe pengon kryerjen e duhur të procesit ose se një avokat është neglizhues ose ndryshe nuk plotëson standardin e kompetencës dhe etikës profesionale gjatë kryerjes së detyrave të tij, pasi e paralajmëron në kohë avokatin Dhoma:
> (i) refuzon ta dëgjojë avokatin; dhe/ose
> (ii) pasi i jep mundësi avokatit të shprehë mendimin e tij, vendos se avokati nuk është më i përshtatshëm për paraqitjen e një të akuzuari para Tribunalit bazuar në Rregullat 44 dhe 45.
>
> (B) Me miratimin e Kryetarit, një Gjykatës ose një Dhoma gjithashtu mund ta përcjellë shkeljen e avokatit në organin profesional rregullator të sjelljes së avokatëve në vendin ku avokati ushtron profesionin ose n.q.s është profesor i të drejtës në universitet dhe ndryshe që nuk ushtron profesionin, në strukturën drejtuese të Unibversitetit të avokatit.
>
> (C) Nën mbikëqyrjen e Kryetarit, Sekreari publikon dhe përcjell zbatimin e Kodit të Sjelljes Profesionale për avokatët e mbrojtjes.

5. Dhoma mendon se megjithëse Rregulla 46 përqëndrohet mbi shkeljet e avokatëve të Mbrojtjes,[7] nuk është vendimtare çështja nëse Rregulla 46 duhet zbatuar vetëm në lidhje me avokatët e Mbrojtjes apo mund të zbatohet edhe për avokatët e akuzës.[8] Sipas Nenit 20 të Statutit të Tribunalit Dhoma ka detyrim të garantojë që gjykimi të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procesi të kryhet duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Rrjedhimisht Dhoma ka kompetencë të vetvetishme të trajtojë shkeljet prej avokatëve të akuzës që do të ndikonin negativisht në këto interesa pa kompetencën e shprehur të disiplinimit ndaj anëtarëve të Prokurorisë sipas Rregullës 46 të Rregullores. Rregulla 46(A) e Rregullores mund të shërbejë si udhëzues për Dhomën kur ajo shqyrton nëse një avokat i Prokurorisë kreu shkelje.

6. Dhoma trajton kryesisht shkelje të avokatëve që konsistojnë në sjellje fyese, keqpërdoruese dhe penguese gjatë seancave gjyqësore. Mirëpo shkelja nuk kufizohet vetëm në sjelljen në gjykatë. Shkeljet profesionale të avokatëve jashtë gjykatës gjithashtu mund të

[7] Fjala "avokat" nuk përkufizohet në Rregullën 2 të Rregullores dhe në Rregullën 46 duket se kjo fjalë do të thotë "avokat i Mbrojtjes". Shih Rregullën 46(A)(ii) dhe (C).
[8] Dhoma thekson se Prokurorja, në përputhje me Tregullën 4 të Standardeve, merr si të vërtetë se Rregulla 46 e Rregullores është e vlefshme për avokatët e Prokurorisë.

cënojnë interesat e lartpërmendura, n.q.s. kanë lidhje te drejtpërdrejtë ose të tërthortë me procesin.

7. Veç paraqitjes së Znj. Del Ponte në gjyq gjatë deklaratës hapëse, në këtë çështje bazuar në praktikën e përgjithshme Prokurorja është përfaqësuar nga avokatët e saj gjyqësorë. Veç detyrave normale Prokurori/ja ka një detyrim më të gjerë në përfaqësimin e funksionit të saj në publik dhe në forume si Këshilli i Sigurimit. Në trajtimin e çështjes nëse Zj. Del Ponte ka bërë shkelje, Dhoma gjithashtu do të shqyrtojë më gjerësisht rolin që Znj Del Ponte kishte si Prokurore.

8. Megjithëse Zj. Del Ponte pa dyshim komentoi në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e njërit prej të Akuzuarve, Dhoma pranon se kjo u bë në kontekst të theksimit të qëndrimit të Zyrës së Prokurores se ekzistonin prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të Akuzuarit. Deklarata e saj sipas citimit nga revista "Der Spiegel" dhe që iu bë e ditur Dhomës nëpërmjet Kërkesë,s nuk ka cënuar në asnjë lloj mënyre ndershmërinë ose shpejtësinë e procesit gjyqësor. Dhoma nuk do të trajtojë në përgjithësi rrethanat në të cilat Prokurorja ka detyrim të korrigjojë deklarata ose pyetje të pasakta prej gazetarëve. Për këtë rast vërtetoohet se Znj. Del Ponte nuk konfirmoi komentin e intervistuesit në lidhje me vrasjen e disa dëshmitarëve, por shpjegoi se zyra e saj kishte ndeshur në vështirësi të mëdha për marrjen e dëshmive prej dëshmitarëve. Më tej, Znj. Del Ponte theksoi se megjithëse ekzistonte programi për mbrojtjen e dëshmitarëve, dëshmitarët ishin të shqetësuar dhe shpesh nuk kishin dëshirë të largoheshin nga Kosova për këtë qëllim. Dhoma konkludon se shpjegimi dhe komentet e Znj. Del Ponte nuk cënuan ndershmërinë dhe shpejtësinë e procesit gjyqësor.

9. Si përfundim, Dhoma konkludon se deklarata e bërë prej Znj. Del Ponte dhe e përmendur në Kërkesë nuk ishte në asnjë mënyrë e tillë që do të ndikonte negativisht në një gjykim të drejtë dhe të shpejtë që rrjedhimisht do të përligjte mbajtjen e një seance paraprake.

10. Për arsyet e mësipërme Kërkesa **REFUZOHET.**

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Alphons Orie
Kryegjykatës

Sot, më datën 29 janar 2008
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]